



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivery	27-02-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shteti e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	2740/2023		117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.57/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.57/2023 të datës 12.01.2023 të parashtruar nga ankuesja e përfaqësuar nga Zyra Ligjore me adresë Rruga ' Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.57/2023 e datës 12.01.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Ndryshohet Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 12.12.2022 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesen dhe atë nga një pikë tetë (1.8) bëhet dy pikë nëntë (2.9), "mirë".
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesen si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësës civile.
- IV. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Ar sy e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës/Departamenti: Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim në vendin e punës "Zyrtare e Lartë për Asistencë Zhvillimore", e pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë, më datë 12.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Punës të datës 12.12.2022 me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 08.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 19.01.2023 përmes Zëvendës Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 12.01.2023 me Nr.Prot:213/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërim AE.Nr.43/2021 i datës 22.06.2021; Përshkrim i detyrave të punës; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 12.12.2022; Kërkesë për transferim të nëpunësit civil me nr.prot.2814 i datës 14.11.2022; Përgjigje në kërkesën me Nr. Prot. 2642/4 e datës 29.11.2022; Vendim i Sekretarit të Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me nr.prot.115/2022 i datës 29.11.2022; Njoftim për gjendjen e papërbalueshme në Zyrën e Bashkëpunimit për Zhvillim me nr.prot.2422 i datës 14.10.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar K.H i datës 07.03.2022; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar F.C i datës 30.03.2022; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar F.C i datës 22.03.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K i datës; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K i datës 07.07.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K i datës 05.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K i datës 15.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K i datës 24.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K i datës 26.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K i datës i datës 06.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K i datës i datës 11.08.2022; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar B.B i datës 12.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar R.V i datës 12.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.B i datës 14.03.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.B i datës 04.03.2022; E-mail i dërguar nga A.B drejtuar F.C i datës 10.02.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar F.C i datës 27.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar F.C i datës 13.07.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar K.H i datës 15.03.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar A.K e datës 10.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar A.K e datës 24.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; Ftesë për konferencë e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C

drejtuar A.P e datës 17.06.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar A.K e datës 17.06.2022; E-mail i dërguar nga E.P drejtuar A.P e datës 03.10.2022; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar nga A.K 26.08.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 26.08.2022; E-mail i dërguar nga GIZ drejtuar K.H e datës 05.10.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar K.H e datës 26.08.2022; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K e datës 06.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga drejtuar F.C i datës 30.03.2022; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar F.C e datës 01.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.B drejtuar F.C e datës 01.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar K.H e datës 01.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar F.C e datës 22.03.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar K.H e datës 24.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; Vërejtje e lëshuar nga Zyra e Kryeministrit për ankuesen me numër 11/2022 e datës 24.06.2022; Formulari për vlerësimin në punën provuese e datës 22.06.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 23.01.2022; Vërejtje e lëshuar nga Zyra e Kryeministrit për K.H me numër 30/2022 e datës 24.08.2022; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K e datës 24.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga K.H drejtuar A.K e datës 26.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar L.SH e datës 12.01.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar SH.K, etj e datës 08.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 19.01.2023; Përgjigja në ankesë e datës 30.01.2023; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar F.S e datës 17.11.2022; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar F.S e datës 02.11.2022; E-mail i dërguar nga F.S drejtuar F.C e datës 23.05.2022; E-mail i dërguar nga F.S drejtuar A.P e datës 05.12.2022; E-mail i dërguar nga F.S drejtuar A.P e datës 09.12.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.S drejtuar A.P e datës 08.12.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.S drejtuar F.C e datës 21.06.2022; Udhëtimet zyrtare të ankueses për vitin 2021-2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 12.12.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar M.V e datës 04.10.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 08.08.2022; me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 12.08.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 15.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 24.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 26.08.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar L.P e datës 26.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 26.08.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; Vendim i lëshuar nga Komisioni për Planifikim Strategjik me numër 03/2022 i datës 24.08.2022; Shkresë- Informim lidhur me pretendimet e letrës së datës 14.10.2022 me numër të protokollit 2422/2022 i datës 25.10.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar F.S e datës 29.07.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar L.SH, etj e datës 26.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtua R.B e datës 27.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar SH.K etj ne datës 27.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.P drejtuar F.C e datës 16.06.2022; E-mail i dërgua nga F.C drejtuar A.P e datës me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 27.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.B drejtuar A.P e datë 16.06.2022; E-mail i dërguar nga F.C drejtuar A.P e datës 17.06.2022 me korrespondencën e bashkangjitur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore që ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 22.06.2021 mbanë pozitën "Zyrtare e Lartë për Asistencë Zhvillimore" në Departamentin: Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, ndërsa Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Efiçencën të Energjisë, përmes kërkesës së datës 14.11.2022 ka kërkuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës për transferim të përkohshëm të ankueses në interes të institucionit për periudhën kohore prej gjashtë muajve duke filluar nga data 01.12.2022 në Agjencinë e Kosovës për Efiçencën të Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë për tu sistemuar në pozitën "Zyrtare për Planifikim dhe Projekte", kurse Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës përmes Vendimit me nr.prot.115/2022 i datës 29.11.2022 ka transferuar ankuesen në Institucionin përkatës deri me datë 31.05.2023.

Ankuesja pas transferimit të përkohshëm në Agjencinë e Kosovës për Efiçencën të Energjisë ka pranuar Formularin për vlerësim për rezultatet në punë për periudhën kohore nga data 22 qershor deri me datë 30 nëntor 2022 me datë 12.12.2022 nga Drejtori i Departamentit të Asistencës Zhvillimore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës me notë të përgjithshme një pikë tetë (1.8), me arsyetim për mungesë të arritjes së objektivave. Ankuesja ishte vlerësuar për këtë pjesë të mbetur të vitit përpara se e njëjta të transferohet, pasi që periudha provuese iu ka konfirmuar me datë 21.06.2022.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe pranueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses se vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën kohore nga data 22 qershor deri me datë 30 nëntor 2022 nga Udhëheqësi i saj i Drejtpërdrejtë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, në kërkesën për përgjigje në ankesë e protokolluar me numër:551/2023 të datës 19.01.2023, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ndër të tjera, ka kërkuar: "Shkresën me përcaktimin e Objektivave të punës për ankuesen gjatë vitit 2022; si dhe Dëshmi me shkrim nëse ndonjëherë gjatë vitit 2022 udhëheqësi i ankueses ka kërkuar performancë më të mirë, evitim të lëshimeve apo sygjerim në arritjen e objektivave", ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore përmes shkresës së datës 01.02.2023 të nënshkruar nga Zëvendës Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore kanë kthyer përgjigje, mirëpo nuk kanë arritur të dëshmojnë me fakte se cilat kanë qenë realisht objektivat e përcaktuara të punës së ankueses për periudhën në fjalë për të cilat janë pajtuar ankuesja me udhëheqësin e saj siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: "Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2 vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar" nga rrjedh se në mungesë të përcaktimit të objektivave dhe veprimeve të ndërmarra me qëllim të përcjelljes së realizimit të objektivave gjatë vitit vlerësues, Udhëheqësi i Drejtpërdrejt i ankueses ka vepruar në kundërshtim me nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: "Vlerësimi i rezultateve në punë - nënkupton një proces të përhershëm që përfshin

*vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë si dhe në pajtim me këtë Rregullore” si dhe në kundërshtim me nenin 7 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime më nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme”, andaj mbi këtë pikë pretendimi ankimor i ankues se vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën kohore nga data 22 qershor deri me datë 30 nëntor 2022 ndërlidhur me vlerësimin për realizimin e objektivave për vitin 2022 është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike është i qëndrueshëm dhe i bazuar.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit me përgjigjen e datës 19.01.2023 nuk ka pranuar fakte të provueshme se gjatë vitit kalendarik 2022 ankuesja të ketë pranuar ndonjë kërkesë nga udhëheqësi i saj më qëllim të rritjes së performancës apo të arritjes së ndonjë objektivit në mënyrë specifike dhe të përcaktuar qartë, evitim të lëshimeve apo sygjerime në arritjen e objektivave, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankueses nuk i ka përmbushur obligimet mbikëqyrëse siç përcaktohet me nenin 7 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime më nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme”.

Kolegji, po ashtu ka analizuar vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën kohore 22 qershor-30 nëntor 2022 sipas formularit të datës 12.12.2022 dhe ka gjetur se ankuesja për objektivin numër 1 “Programim, koordinim dhe monitorim i instrumenteve financiare të BE-së (IPA, IPA MB, TAIEX, Tëinning, EBIF, CBO)” është vlerësuar me notë 2, si dhe për objektivin numër 2 “Koordinim i donatorëve” është vlerësuar me notë 2, andaj në kuptim të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: “Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.2. nga 1.5 deri më pak se 2.5 nënkupton “kënaqshëm ose mjaftueshëm”; ndërlidhur me nenin 11 paragrafin 2 nën paragrafi 2.4 “kënaqshëm ose mjaftueshëm”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar vetëm disa nga objektivat e punës dhe ka treguar aftësi nën pritjet. Kontributi i tij nuk ka ndikuar, ose ka ndikuar vetëm pjesërisht në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”.

Nga se u tha më lartë, Kolegji i këshillit, mbi bazën e shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, analizimit të dispozitave ligjore si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses se vlerësimi i bërë me datë 12.12.2022 nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, pasi që i njëjti me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen është dashur të vlerësojë vetëm për objektivat e caktuara paraprakisht për të cilat është dashur të vihet në dijeni ankuesja, parakushte këto të cilat nuk janë sqaruar mjaftueshëm me rastin e dërgimit të shkresës me provat e lëndës me datë 01.02.2023, prandaj duke u mbështetur në nenin

13 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *“Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)”*, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se mbi bazën e të gjeturave dhe vlerësimeve si më lart, ka ndryshuar Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë të datës 12.12.2022 për ankuesen ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare një pikë tetë (1.8), ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare dy pikë nëntë (2.9) apo mirë, pasi që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit theksohet fakti se nuk mund të ketë vlerësim apo matje reale të objektivave, nëse të njëjtat nuk janë përcaktuar paraprakisht dhe për të cilat ankuesja nuk ka qenë e njoftuar në kohë, sikurse përcaktohet me nenin 6 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike: *“Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë”*, dhe mbi këtë bazë në mungesë të përcaktimit të objektivave, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen nuk ka qenë real, gjegjësisht një veprim i tillë është në kundërshtim edhe parimet e përgjithshme të përcaktuara me nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar.

Përveç tjerash, Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesja, sipas formularit të përshkrimit të detyrave të punës të përcaktuara mbi bazën e pozitës së punës *“Zyrtare e Lartë për Asistencë Zhvillimore”* sipas akt emërimit të datës 22.06.2021, ka edhe të tjera detyra të punës nga ato për të cilat është vlerësua të përcaktuara si objektiva të punës pa e njoftuar ankuesen, gjegjësisht ankuesja sipas e-maileve të datës 29.03.2022, 16.06.2022, 17.06.2022, dhe 26.08.2022 vërehet qartë se e njëjta ka pasur përkushtim në realizimin e detyrave të punës për pacaktuara sipas përshkrimit të pozitës që mban, sikurse nga e-mailet e lartcekura me data referente e njëjta shpreh shqetësimin tek udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë për mungesën e ndarjes së informacioneve që vijnë nga donatorët apo programet nga organizatat e jashtme si pjesë e programe në fushën e Efiçencën së Energjisë, sikurse e njëjta ka njoftuar edhe zyrtarin më të lartë administrativ-Sekretarin e Përgjithshëm për sfidat që kanë si zyre dhe po ashtu në të njëjtin e ka mbajtur të informuar lidhur me procesin e punës, sikundër kësaj po ashtu nga shkresat e lëndës ankuesja vërehet se sipas formularit të vlerësimit të rezultateve në punë i datës 31.01.2022 e njëjta është vlerësuar me notë pesë (5) *“shkëlqyeshëm”* notë e cila është më e lartë në kuptim pozitiv që mund t’i atribuohet një nëpunësi civil në kuadër të shërbimit civil, sikurse të njëjtës i është konfirmuar edhe vlerësimi i periudhës provuese, andaj ndërlidhur me gjendjen faktike ndërmjet vlerësimit me notë pesë (5) sikurse është konstatuar edhe gatishmëria e ankueses për të përmbushur detyrat e punës sikurse u potencua në e-malit e lartcekura, pavarësisht mungesës së ndarjes me kohë të informacionit dhe mungesës së përcaktimit paraprakisht të objektivave, andaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshilli konstatohet se ankuesja ka treguar aftësi të pritshme të e punës, dhe për të njëjtin angazhim nota e saj për vlerësimin e përgjithshëm ndryshohet dhe bëhet dy pikë nëntë (2.9) apo *“mirë”* siç përcaktohet me nenin 11 paragrafin 2 nen paragrafin 2.3 Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ndërsa ky vendim e zëvendëson formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 12.12.2022, njëherit Njësia e Burimeve Njerëzore obligohet që në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të njëjtin ta vendos në dosjen personale të ankueses.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.57/2023

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Baslikëpunim Profesional*

**Eshref SHBANI**

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësueses së ankueses, Zyra Ligjore
- Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.